

sur në varrezat e Pejës/Peć më 16.08.1998. Ata ishin të sigurt se bëhej fjalë për Cymen, por nuk e zhvarrosën varrin e saj të supozuar.

Burimi: deklarata R.Sh, FDH-19516.

Goran (Dragoljub) Petrović

(15.10.1968, serb nga Beogradi, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Gorani e ka mbaruar trajnimin për oficer policie në vitin 1995, kur u punësua në Shërbimin e Sigurimit Shtetëror të Serbisë. Nga viti 1997, ka qenë pjesëtar i Njësiteve për Veprime Speciale. Në mëngjesin e datës **15.08.1998**, Gorani, së bashku me shtatë apo tetë policë nga Peja/Peć, u nis për në Junik [Deçan/Deçani]. Rrugës e sipër, u ndalën në **Loxhë/Loda**. Në çastin kur ishte duke dal nga makina, Goranin e kanë qëlluar ciflat e predhës që eksplodoi pranë tyre. Familjarët e tij, më vonë, kishin dëgjuar nga kolegët e Goranit se predha ishte shkrepuar nga ana serbe. Goranin e kanë varrosur në Varrezat e Reja në Rushënj më 17.08.1998.

Burimet: deklarata D.P, FDH-34589; SMIP, Teroristički., III, 938; KMKRFJ, Personat., FDH-10832; SV SRJ, Junaci otadžbine, 52; Z. Stijović, Kosmet., 110; M. Sekulić, Beograd., 73; Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998.godini, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

Brahim (Bekë) Novaj

(1934, shqiptar nga Dobërdoli/Dobri Do, komuna e Pejës/Peć, bujk, katër fëmijë)

Për shkak të problemeve me policinë serbe, Brahimi me bashkëshorten u larguan nga shtëpia në vitin 1997. Kaluan te një mik në anën tjetër të fshatit. Në datën 15.08.1998, pjesëtarë të forcave serbe kanë filluar të bombardonin **Dobërdolin/Dobri Do**. Brahimi dhe bashkëshortja, si dhe banorë të tjerë të fshatit, i braktisën shtëpitë dhe u strehuan në pyllin e afërt. Pas mesnate, më **16.08.1998**, rreth orës 2:00, një predhë ka rënë pranë Brahimit duke ia marr jetën në vend. Ditën tjetër, në mëngjes, farefisi dhe disa banorë të fshatit e kanë varrosur

Brahimin në livadhin e Rustem Berishes. Pas përfundimit të luftës, familjarët u kthyen në fshat dhe i rivarrosën mbetjet mortore të Brahimit në varrezat e Dobërdolit/Dobri Do, në muajin shtator të vitit 1999.

Burimi: deklarata M.N, FDH-14577.

Zoran (Vitomir) Aničić

(26.09.1970, serb nga Prijepole, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas mbarimit të shkollës së mesme tregtare, Zorani e ka përfunduar edhe trajnimin për polici në Kamenicën e Sremit [Serbi]. Punonte në SPB-në e komunës së Pallillulles [Beograd]. Me vëllain Bobanin jetonin në Beograd. Në datën 15.08.1998, Zoranin e dërguan në Kosovë. Ditën tjetër, më **16.08.1998**, nga ora 23:30, ai e ka humbur jetën në përleshjet me forcat e UÇK-së në **Lubeniq/Ljubenici**. E kanë varrosur në një pronë fshatare Grab [Mali i Zi], më 18.08.1998.

Burimet: deklarata B.A, FDH-27282; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 12; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 938; Z. Stijović, *Kosmet...*, 109.

Milaim (Rexhë) Gjocaj

(2.08.1975, shqiptar nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Avni (Bali) Sinanaj

(12.03.1978, shqiptar nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Agron (Sadri) Gjocaj

(10.04.1978, shqiptar nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Deçani, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Milaimi, Avniu dhe Agroni u bënë anëtarë të UÇK-së në muajin prill të vitit 1998. Që të tre vepronin pranë shtabit të UÇK-së në Baballoq/Babaloc. Avniu ka qenë komandant i njësitit, i cili i numëronte 12 ushtarë. Në datën **18.08.1998**, Milaimi, Agroni dhe Avniu ishin në kuadrin e një grupi ushtarësh të UÇK-së, i cili u nis për në Shqipëri për një ngarkesë të re të armatimeve. Në *Bjeshkën e Dobroshit/Dobroš*, te vendi *Bogiqevica* [Plav, Mali i Zi], kanë rënë në pusi të usht-